



Nr.-186/10-prot


Durrës,më:17/07/2023

URDHËR

"PËR HEQUR MASEN SËKËUESTRO KONSERVATIVE"

Drejtuar :QENDRA KOMBETARE BISNESIT TIRANE

Per dijeni:Debitori:Shoqeria: "EMS - ALBANIAN PORT OPERATOR"(EMS APO) Sh.p.k. NIP 521044004
Adr;Porti Detar- Terminali Lindor Hyrja Nr 5 DURRES



Kreditori: Shoqeria: "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY "Sh.p.k. NIPT K92128501U

Adr:Porti Detar DURRES

Prane Studio Ligjore te Përmbaruesit Gjyqësor privat Eduard Allamani,bazuar në kërkesen e pales kreditore eshte transferuar per ekzekutim "titullit ekzekutiv" te vendimit gjyqesor Nr.11-2018-1229/397, date. 13/03/2018 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres, lene ne fuqi me disa ndryshime me vendimin gjyqesor Nr.10-2020-477/156 date.14/04/2020 te Gjykates Apelit Durres,eshte rregjistruar ceshtja me pale:

-Kreditor: SHOQ: "ALBANIAN STEVEDORING COMPANY " SH.P.K.

-Debitor: SHOQ: "EMS - ALBANIAN PORT OPERATOR"(EMS APO)"SH.P.K.

-Objekti: Permbushje detyrimi, dorezim sendesh dhe pagim shume;

Une Permbaruesi Gjyqesor Eduard Allamani, pasi studiova aktet ne dosjen permbarimore:

K O N S T A T O V A

Ne baze te vendimit gjyqesor Nr.10-2020-477/156 date.14/04/2020 te Gjykates Apelit Durres, nder te tjera eshte vendosur: -Lenien ne fuqi te vendimit gjyqesor 11-2018-1229/397,date.13/03/2018 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres per sa i perket:

Pranimet te padise per kerkimin e detyrimit te pales se paditur te ktheje automjetet, mankinerite e pajisjet.

Rrezimit te padise per kerkimin,'Detyrimin e te paditurit ti shperbleje paditesit demin per humbjen,demtimit ose pamundesine e kthimit te sendeve te ndodhura gjate kohes se posedimit te tij".

Ndryshimin e vendimit si me poshte:

Detyrimin e pales se paditur Shoqeria: ""EMS - Albanian Port Operator"(EMS APO)"Sh.p.k. qe ti paguaje paditesit Shoqeria: Albanian Stevedoring Company" Sh.p.k.,fitimin e munguar ne shumen 15,498,963 leke dhe prej dates 26/09/2017, fitimin e munguar ne shumen 16,091 leke, deri ne vendosjen e pajisjeve ne posedimin e pales paditese..

-Rrezimin e kerkimit per pagimin e amortizimit te paisjeve ne shumen 40,846,976 leke dhe amortizimin ditor ne shumen 19,479 leke/dite deri ne ekzekutimin e vendimit gjyqesor, si te pa bazuar.

Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga Sherbimi Permbarimor:

- Ne ekzekutim te titullit ekzekutiv te sipercituar pala kreditore ka bere kerkese prane Zyres Permbarimit Gjyqesor Privat BEST 2010 Saimir Hoxha dhe me pas me kerkese po te pales kreditore kjo dosje permbarimore eshte transferuar me Vendim Nr.41 Extra, dt.05/02/2021 nga Zyres Permbarimit Gjyqesor BEST 2010 Saimir Hoxha per te Zyra Permbaruesit Gjyqesor Privat Eduard Allamani .

- Ne ekzekutim te titullit ekzekutiv te sipercituar prane Zyres Permbarimit Gjyqesor Privat BEST 2010 Saimir Hoxha, nga ana ketij permbaruesi jane kryer disa veprime,ku eshte ekzektuar vendimi gjyqesor ne lidhje me pjesen qe percakton dorezimin e sendeve nga pala debitore ne favor te pales kreditore, dhe me vendimin 41/6 prot, dt.01/07/2020 eshte pezulluar nga Permbaruesi Gjyqesor Saimir Hoxha, ne zbatim te vendimit gjyqesor te ndermjetem Nr.107,dt.01/07/20220 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres.

Per vendimi gjyqesor te siper cituar ka qendruar pezullimi deri ne perfundim te procesit gjyqesor perkates.

- Me vendimin gjyqesor Nr.(11-2021-3190)668,date.24/05/2021 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres, eshte vendosur:

-Pranimin e kerkese padise se pales paditese Shoqeria: "EMS - Albanian Port Operator"Sh.p.k. duke deklaruar se detyrimi ndaj pales se paditur Shoqerise: Albanian Stevedoring Company" Sh.p.k. ne zbatim te titullit ekzekutiv vendimin gjyqesor Nr.10-2020-477/156 date.14/04/2020 te Gjykates Apelit Durres shumen 30.704.958 leke.

-Ndarjen dhe pagimin e ketij detyrimi nga pala paditese Shoqeria: "EMS - Albanian Port Operator"Sh.p.k. me 24 keste (dy vjet)duke paguar pala paditese shumen 1,279.373 leke ne muaj nga data kur ky vendim do te marre forme te prere.

-Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe eshte i ekzekutueshem nga Zyra e permbarimit shteteror ose privat.

-Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pale se paditur ne vleren 4,100 leke.

Ne ekzekutim te vendimit gjyqesor te cituar me lart jane kryer disa veprime nga Zyra Permbarimit Gjyqesor BEST 2010 Saimir Hoxha dhe me pas nga Zyra Permbaruesit Gjyqesor Privat Eduard Allamani.

Pala kreditore me shkersen e saj dt.14/07/2023 nder te tjera pershkruhet se eshte permbushur detyrimi i plote nga pala debitore dhe kerkon te pushohet ekzekutimi i titulli ekzekutiv te sipercituar.

Në kushtet kur për ekzekutimin e titullit ekzekutiv,eshte kaluar ne ekzekutim te detyruar,duhet të sekuestrohen pasurite e debitorit, ne rastin konkret duhet te kryhej bllokimi per kuotat-aksionet asetet etj te debitorit per detyrimin.

Meqenese eshte permbushur detyrimi nga pala debitore ne favor te pales kreditore, do te hiqet masa sekuestro konservative e vendsour mbi kuotat-aksionet asetet etj te pales debitore e vendosur nga ana Zyres Permbarimit Gjyqesor BEST 2010 Saimir Hoxha, ne lidhje me kete detyrim ne lidhje me titullin ekzekutiv te cituar me lart.

Nisur sa me siper e zbatim te neneve 527,589,593,vijues te K.Pr.civile dhe ligjit Nr.26/2019 "Per Sherbimin Permbarimit Gjyqesor Privat".

URDHËROHENI

1-Qendra Kombetare Bisnesit Tirane, menjehere te kryhen veprimet perkatese dhe te hiqet masa sekuestro konservative mbi kuotat-aksionet asetet etj,te pales debitore: Shoqeria:"EMS -Albanian Port Operator"(EMS APO) Sh.p.k. me NIPT L31804506A,duhet te c'bllokohen kuotat-aksionet asetet etj dhe te lihen te lira persa eshte urdheruar me Urdher Nr.41/1 Prot, dt.01/06/2020, "sekuestro te aseteteve te debitorit" nga permbaruesi gjyqesor Zyra Permbarimit Gjyqesor BEST 2010 Saimir Hoxha, ne lidhje me kete titull ekzekutiv te sipercituar.

2- Për veprimet tuaja të njoftoni zyrtarisht brenda afatit ligjor.

3-Personat qe bëhen pengese për zbatimin e këtij urdhri,do te pergjigjen sipas nenit 598 e ne vijim te K.Pr. Civile dhe dispozitave te Kodit Penal.

4-Ky urdhër,u njoftohet paleve dhe kane te drejten e ankimit në Gjykatë brenda 5 diteve.

Duke ju falënderuar per bashkpunimin:

PERMBARUESI GJYQESOR

/EDUARD ALLAMANI

